

Emri i Lëndës : Procedurë Penale e Avancuar me Praktikë Gjyqësore							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 433	B	Vjeshtë	4.00	0.00	0.00	4.00	6.00
Lektori		Adnan Xholi, PhD					
Asistenti		Fioralba Markja, Msc					
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		Procedura Penale e Avancuar me praktikë gjyqësore, është lënda mësimore e cila shpjegon nga ana teorike dhe praktike legjislaionin procedural penal, institutet dhe dispozitat që rregullojnë procedimin penal në të gjitha fazat e tij. Ajo analizon shkencërisht sistemet procedurale penale, zhvillimin historik të legjislaionit procedural në Shqipëri deri në miratimin e Kodit të Ri të Procedurës Penale, si dhe parimet demokratike në të cilat bazohet procedimi penal. Analiza e përcaktime të hollësishme bëhen për subjektet e procedimit penal, për vendin që zënë, rolin që luajnë dhe raportet midis tyre; për kuptimin, llojet dhe çmuarjen e provave; kushtet dhe kriteret që duhen zbatuar në marrjen e masave të sigurimit; detyrat e prokurorit dhe të policisë gjyqësore gjatë fazës së hetimeve paraprake; rregullat e gjykimit në shkallë të parë; kuptimin dhe veçoritë e gjykimit në apel si dhe në Gjykatën e Lartë; mënyrën e ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë; marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja etj. Programi është ndërtuar në përputhje me strukturën e Kodit të Procedurës Penale dhe për leksione të caktuara parashikon seminare teoriko- praktike, në të cilat diskutohen përmbajtja e lëndës, lidhur me praktikën gjyqësore, duke u konkretizuar me vendimet e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe të Apeleve; vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vendimet Unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; vendimet e Gjykatës Kushtetuese, si dhe vendimeve të GJEDNJ, për çdo parim apo dispozitë të trajtuar gjatë leksioneve. Studentët do të kenë mundësinë që të debatojnë rreth këtyre vendimeve mbi parimet dhe dispozitat konkrete të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale.					
Objektivat		Objektivi kryesor është që në mbarim të ciklit të leksioneve studentët të kenë një infomacion të gjerë jo vetëm teorik por edhe të kuptojë në mënyrë praktike si gjejnë zbatim parimet e sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale. Përgatitja e juristëve të ardhshëm me njohuri të zgjeruara në fushën e procesit penal në përputhje me standardet ndërkombëtare të vendosura për këtë qëllim, të aftë për dhënien e drejtësisë në luftën kundër kriminalitetit, duke respektuar të drejtat e njeriut. Rritja e nivelit të formimit teorik të tyre nëpërmjet njohjes me të thelluar të mendimit të përparuar bashkëkohor për ndarjen e pushteteve, sistemet procedurale, parimet dhe institutet kryesore të procedimit penal etj. Kuptimin e drejtë të vendit që zenë dhe rolit që luajnë subjektet e procedimit penal, raportet midis tyre, të drejtat dhe detyrimet që kanë dhe mënyra e realizimit te tyre në praktike.					
Konceptet Kryesore		1. Të arrijnë që të identifikojnë dhe të bëjnë dallimin mes subjekteve të procedurës penale, të drejtat e tyre në një proces; 2. Të jenë të aftë të përgatisin aktet të ndryshme procedurale në përputhje me kërkesat e ligjit dhe rregullat gjuhësore e ato logjike, duke filluar nga marrja e kallëzimit, deri tek vendimi gjyqësor i formës së prerë e mandej tek vënia e tij në ekzekutim; 3. Të kenë aftësinë që të interpretojë dhe shpjegojë dispozitat e K.Pr.Penale, të kuptojë problemet procedurale të hasura në praktikë, si dhe të japin vlerësimin mbi mënyrën e zgjidhjes së tyre, etj.					
Programi i Lëndës							
Java		Tema					
1		Prezumimi i pafajësisë. Islami H., Hoxha A., Panda I (2017): Procedura Penale, Tiranë: 54-56					

2	Ndalimin e gjykit dy herë për të njëjtin fakt penal, parimi i gjësë së gjykuar “ne bis in idem”. Islami H., Hoxha A., Panda I (2017): Procedura Penale, Tiranë: 57-61
3	I pandehuri. Marrja e cilësisë së të pandehurit, ndryshimi ose plotësimi i akuzës, të drejtat e personit nën hetim apo të pandehurit. Të drejtat e të arrestuarit dhe ndaluarit. Islami H., Hoxha A., Panda I (2017): Procedura Penale, Tiranë: 120-131
4	Sigurimi i mbrojtjes në një proces penal dhe mbrojtësi i të pandehurit. Personi juridik si i pandehur (garancitë procedurale). Neni 6,i K.Pr.Penale; Islami H., Hoxha A., Panda I (2017): Procedura Penale, Tiranë: 56-57
5	Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (reformatio in peius). Islami H., Hoxha A., Panda I (2017): Procedura Penale, Tiranë: 57-62
6	Përgjimet si mjet për kërkimin e provës në procesin penal. Islami H., Hoxha A., Panda I (2017): Procedura Penale, Tiranë: 280-288
7	Pavleshmëria e akteve dhe papërdorshmëria e provave. Islami H., Hoxha A., Panda I (2017): Procedura Penale, Tiranë: 177- 193
8	Provim Gjysmëfinal
9	Gjykimi në mungesë. Mungesa e të pandehurit ose e mbrojtësit. Mosparaqitja ose largimi i vullnetshëm i të pandehurit. Islami H., Hoxha A., Panda I (2017): Procedura Penale, Tiranë: 459-467
10	Masat e sigurimit personal. Ndarja e masave të sigurimit. Kushtet, kriteret dhe kriteret e veçanta për caktimin e tyre. Zëvendësimi ose bashkimi i masave të sigurimit personal. Masat shtrënguese dhe ndaluese. Islami H., Hoxha A., Panda I (2017): Procedura Penale, Tiranë: 304-327
11	Masat e sigurimit pasuror. Sekuestroja konservative dhe preventive. Humbja e fuqisë së sekuestros. Ankimi kundër vendimit. Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive sipas Ligjit “Antimafia” me Nr.10 192, datë 3.12.2009, i ndryshuar. Islami H., Hoxha A., Panda I (2017): Procedura Penale, Tiranë: 385-388
12	Ankimi, Rivendosja në afat e të drejtës së ankimit. Gjykimi në Gjykatën e Apelit, Gjykimi në Gjykatën e Lartë dhe kompetencat e shqyrtimit të Gjykatës Kushtetuese. Islami H., Hoxha A., Panda I (2017): Procedura Penale, Tiranë: 525-581
13	Juridiksioni dhe kompetenca. Llojet e tyre. Mosmarrëveshjet për kompetencën. Bashkimi dhe ndarja e çështjeve. Raste praktike të zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve mbi kompetencën. Islami H., Hoxha A., Panda I (2017): Procedura Penale, Tiranë: 525-581
14	Marëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja (Ekstradimi, Njohja e vendimeve penale të huaja, Letërporositë etj). Islami H., Hoxha A., Panda I (2017): Procedura Penale, Tiranë: 645-720
15	Rishikimi. Vendimet që mund të rishikohen, rastet e rishikimit, kërkesa e rishikimit dhe forma e kërkesës. Gjykimi i kërkesës, disponimi i gjykatës në rastet e pranimi të kërkesës dhe ekzekutimi i vendimeve penale. Islami H., Hoxha A., Panda I (2017): Procedura Penale, Tiranë: 581-586
16	Provim Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Kodi i Procedurës Penale, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin Nr.7905, datë 21.3.1995 (së bashku me shtesat dhe ndryshimet përkatëse • Islami H., Hoxha A., Panda I: Procedura Penale, Tiranë 2003, i ribotuar në 2005, 2007, 2010, 2012, 2014, 2017, Shtëpia Botuese "MORAVA". • Trenova, G. "Komente (dhe praktikë) për procedurën penale", Tiranë, 2017.
Referenca të tjera	• Vendime të Kolegjeve penale të Gjykatës së Lartë, si dhe vendimet unifikuese të Kolegjit penal të Gjykatës së Lartë. • Vendime të Gjykatës Kushtetuese. • "Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut", Romë 04/11/1950, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.8137, datë 31/07/1996. • Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1998. • G Trenova, "Komente (dhe praktikë) për Procedurën penale" (Tiranë: 2011) • Kodi i procedurës penale (me praktikë gjyqësore), Botim i vitit 2010
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Në përfundim të lëndës studenti do të jetë në gjendje të ketë njohuri të thella në fushën e procesit penal në përputhje me standardet ndërkombëtare
2	Studentët do të njohin me hollësi të gjithë subjektet e procedimit penal, të drejtat dhe garancitë e tyre në një proces penal.
3	Studentët e rinj, do jenë të aftë të kuptojnë, përpilojnë dhe kthejnë përgjigje mbi kërkesat që mund dhe duhet të depozitohen pranë organit procedues nga subjektet e procedimit penal, sipas afatefe dhe dispozitave konkrete.
4	Në vijim, mendoj se do jenë të gatshëm për tregun e punës nëpërmjet të menduarit, të shkruarit dhe të folurit si një jurist i kompletuar.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	10	10
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			140
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.60
ECTS			6.00